

Dt. 03.04.2021

069 1959



KËRKESË - PADI

DREJTUAR :

KOLEGJIT ZGJEDHOR

TE GJYKATES SE APELIT ADMINISTRATIV
TIRANE

PADITES :

Koalicioni Partia
Demokratike - Aleanca
për Ndryshim

Bulevardi Zhan d'Ark, Tiranë

0694007.889 , 0682077094.

I PADITUR :

KOMISIONI QËNDROR I ZGJEDHJEVE

PERSON III :

Partia Socialiste e Shqipërisë- Sheshi "Austria", Nr 91, Tiranë

0692045864

Partia Bindja Demokratike- Rruga e Elbasanit, Nr.11, Tiranë

0692021504

OBJEKTI:

- 1) Kundërshtimi i Vendimit të KQZ/KAS Nr. 19 datë 03.04.2021.
- 2) Gjykimi i çështjes në themel duke vendosur pranimin e kërkesës ankimore nr.10 të paraqitur nga Koalicioni Partia Demokratike- Aleanca për Ndryshim dhe rrëzimin e kërkesave ankimore nr.08 dhe 09 të paraqitura nga Partia Socialiste e Shqipërisë dhe Partia Bindja Demokratike.

Vendimi

Titulli i Vendimit

Nr.

Datë

"Për shqyrtimin bashkërisht të kërkesave ankimore nr.08 të Partisë Socialiste të Shqipërisë, nr. 09 të Partisë Bindja Demokratike dhe nr. 10 të Koalicionit Partia Demokratike- Aleanca për Ndryshim"

19

03/04/2021

BAZA LIGJORE:

Neni 66, 67, 98 dhe 145 e vijues, i Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.



I. PARAQITJA E FAKTEVE

Në datën 03.04.2021 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nëpërmjet trupës së Komisionit të Ankimit dhe të Sanksioneve ka marrë në shqyrtim bashkarisht kërkesat ankimore nr. 08.09. dhe 10 të paraqitura përkatësisht nga Partia Socialiste e Shqipërisë, Partia Bindja Demokratike dhe Koalicioni Partia Demokratike- Aleanca për Ndryshim, të cilat së bashku kundërshtojnë vendimarrjen nr. 198 dt.01.04.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e përmbajtjes së fletëve të votimit për zgjedhjet për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”

Pas një debati të gjatë dhe shterues në të cilin palët argumentuan këndvështrimet dhe arsyet e tyre se përse vendimarrja nr 198/ 2021 e komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve duhej ndryshuar, KAS me shumicë votash vendosi:

-Ndryshimin e vendimit nr.198. datë 01.04.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e përmbajtjes së fletëve të votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.

-Pranimin e kërkesës ankimore nr. 08 të paraqitur nga Partia Socialiste e Shqipërisë.

-Pranimin e kërkesës ankimore nr. 09 të paraqitur nga Partia Bindja Demokratike, duke vendosur në përmbajtje të fletës së votimit logon e ristilizuar të depozituar nga ky subjekt zgjedhor.

-Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 10 të paraqitur nga koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim.

Kjo vendimarrje është në kundërshtim me dispozita urdhëruese të ligjit zgjedhor, dhe si e tillë duhet të ndryshohet nga ana juaj.

II. SHKELJA LIGJORE

Në datën 01.04.2021 me anë të vendimarrjes nr. 189, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka disponuar për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për zgjedhjet për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 prill 2021, sipas modelit bashkangjitur vendimit.

Së pari: Pavarësisht se kjo vendimarrje është e drejtë dhe respekton kriteret e parashikuara në nenin 98 pika 4 të Kodit Zgjedhor, pasi parashikon identifikimin me numër dhe me emër të kandidatëve të secilit subjekt zgjedhor ajo vjen në kundërshtim me kriterin e qartësisë që kjo dispozitë parashikon.

Në këtë mënyrë Komisioneri, duke miratuar një fletë votimi të ndryshme nga ajo që është përzgjedhur si fituese nga qytetaret dhe nga vetë propozimi i tij i mëparshëm dukshëm ka shpërfillur kriterin ligjor të qartësisë së fletës së votimit.

Së dyti: Në datën 30.03.2021 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, i ka propozuar Rregullatorit projekt aktet përkatëse me përmbajtjen dhe modelin e fletëve të votimit të cilat do të përdoren në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021 në të gjitha zonat zgjedhore.



Nga shqyrtimi i kujdesshëm i këtij projekt akti kemi vërejtur se emblema (sigla e propozuar) e subjektit Bindja Demokratike është shumë e ngjashme dhe krijon konfuzion dhe lajthitje të votuesve me emblemën (siglën) e subjektit zgjedhor Koalicionit “Partia Demokratike- Aleanca për Ndryshim”. Kjo situatë është marrë në konsideratë nga legjislatori, i cili në nenin 66 të Kodit Zgjedhor, i cili ka parashikuar zgjidhje për situata të tilla.

Duke konsideruar se emri i koalicionit tonë dhe sigla përkatëse, janë historike dhe të njohura për zgjedhësit, pasi figurojnë të tilla në të gjitha proceset zgjedhore pas vitit 1991 kemi kërkuar nga ana e Komisionerit marrjen e masave përkatëse për zgjidhjen e kësaj problematike duke i ndaluar subjektit Bindja Demokratike përdorimin e logos në fletën e votimit, sipas modelit të propozuar prej saj, kërkesë e cila nuk është marrë para sysh në vendimarrjen 198/2021, në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të Kodit Zgjedhor.

Të dyja këto problematika, të cilat i kemi vërejtur te vendimarrja e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve si dhe i kemi kundërshtuar në KAS, jo vetëm që nuk janë trajtuar me zgjidhje ligjore nga ana e KAS, por përkundrazi këto problematika janë trajtuar në favor të interesave elektorale të subjekteve Partia Socialiste e Shqipërisë dhe Partia Bindja Demokratike.

III. LIGJI I ZBATUESHEM

Në zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshje vlerësojmë se Kolegji Zgjedhor duhet të mbajë parasysh dispozitat e mëposhtme të Ligjit nr.10 019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar:

Neni 66

Identifikimi i subjekteve zgjedhore

Nëse dy parti politike ose koalicione kanë emër ose emblemë të njëjtë apo të ngjashme në atë masë sa që mund të shkaktojë konfuzion ose lajthitje të votuesve, atëherë KQZ-ja vendos cila parti ose cili koalicion ka të drejtë të përdorë emrin ose emblemën 34 përkatëse për qëllime zgjedhore, duke marrë në konsideratë datën e themelimit ligjor të partive ose datën e regjistrimit të parë të koalicionit në KQZ. Për të përcaktuar datën e parë të regjistrimit të koalicioneve, KQZ-ja i referohet edhe zgjedhjeve të mëparshme.


Neni 98

Përmbajtja e fletëve të votimit

4. Fleta e votimit për zgjedhjet për Kuvendin duhet të përmbajë hapësirën e posaçme për ushtrimin e votimit parapëlqyes për kandidatët e subjektit zgjedhor. Mënyra e votimit parapëlqyes përcaktohet nga KQZ-ja në varësi nga numri i subjekteve pjesëmarrëse në zgjedhje, duke respektuar kushtin që informacioni i përcjellë nga fleta e votimit të mos jetë tejte i ngarkuar, konfigurimi i fletës të jetë i qartë e i kuptueshëm për zgjedhësin dhe zgjedhësi ta ketë të lehtë orientimin për votimin e subjektit

Neni 145

E drejta e ankimit në gjykatë



3

1. Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë kundër vendimeve të KQZ-së, kur ato cenojnë interesat e tyre të ligjshëm brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të këtij Kodi. Të drejtën e ankimit, sipas këtij neni, e kanë edhe individët ose partitë politike, të cilëve u është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor.

Neni 152

Afati i ankimit në gjykatë

1. Ankimet, sipas këtij Kodi, paraqiten në Gjykatën e Apelit, Tiranë, e cila ia kalon ato Kolegjit Zgjedhor.
2. Ankimi për të gjitha vendimet që KQZ-ja merr në periudhën, e cila fillon 48 orë pas dekretimit të zgjedhjeve të pjesshme ose të përgjithshme deri në përfundim të shqyrtimit administrativ të ankimeve zgjedhore ose të kalimit të afateve të ankimit për zgjedhje, bëhet brenda 5 ditëve nga shpallja e tyre. Për vendimet që KQZ-ja merr jashtë kësaj periudhe, afati i ankimit në Kolegjin Zgjedhor është 30 ditë.

IV. ANALIZA LIGJORE E FAKTEVE

Ashtu si është përshkruar shkurtimisht më sipër, Vendimi nr.19 dt. 03.04.2021 i KAS është i pabazuar në ligj sepse:


Së pari Vendimarrja e KAS nuk merr në konsideratë argumentat tona të ngritura me kërkesën ankimore nr. 10 lidhur me atë cka vendimi nr 198/2021 i Komisionerit nuk ishte në përputhje me parashikimet e nenit 98 pika 4 të Kodit Zgjedhor. Kjo e fundit ndonëse është e drejtë dhe respekton përgjithësisht kriteret, pasi parashikon identifikimin me numër dhe me emër të kandidatëve të secilit subjekt zgjedhor, ajo vjen në kundërshtim me kriterin e qartësisë që kjo dispozitë parashikon.

Versioni i propozuar po nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 31.03.2021 drejtuar Komisionit Rregullator, me të njëjtën përmbajtje por me orientimin *portrait* dhe jo *landscape* (si dhe u miratua) është më i qartë dhe i kuptueshëm për zgjedhësit dhe si i tillë ishte ky variant i cili duhet të miratohej.

Gjithashtu, nga një sondazh që KQZ ka bërë në faqen e vet zyrtare, për të gjitha modelet e fletëve të votimit, fleta e votimit e cila përshkrua kandidatët me emra, por me orientimin *portrait* është ajo që ka marrë mbështetjen më të madhe nga votuesit, në një shumicë dermuese prej 79 përqind.

Asnjë nga këto argumenta nuk u rrëzua gjatë shqyrtimit të kërkesës ankimore në KAS nga asnjë prej palëve të tjera në proces dhe nga ana tjetër nuk është vlerësuar dhe arsyetuar nga ana e KAS në momentin e vendimarrjes përfundimtare.

Mbetemi të qëndrimit se e vetmja fletë votimi e cila respekton kriterin e qartësisë dhe kuptueshmërisë të parashikuar nga ligji në paragrafin 4 të nenit 98 është ajo që qartazi ka rezultuar fituese e sondazhit të organizuar nga vetë KQZ i cili është konsultuar nga dhjetra mijëra përdorues të rrjeteve sociale dhe ka marrë mbështetjen në një përqindje tejet të lartë.



Së dyti Në mënyrë krejtësisht të papranueshme dhe në kundërshtim flagrant me një dispozitë urdhëruese të ligjit zgjedhor, nenit 66 të tij KAS ka lejuar që një subjekt në garën zgjedhore të përdorë një logo (emblemë) të ngjashme me emblemën historike të subjektit tonë, sigël e cila është e njohur prej 30 vitesh dhe familjare jo vetëm për mbështetësit e subjektit tonë por për të gjithë zgjedhësit në Republikën e Shqipërisë.

Në radhë të parë shkelja qëndron në faktin që KAS i ka njohur vetes të drejtën që jo vetëm të verifikojë vendimarrjen e Komisionerit 198/2021, mbi respektimin e kritereve strikt formalë dhe ligjorë të vendimit por kanë marrë tagra që të vlerësojnë edhe ato pjesë të kësaj vendimarrje të cilat janë tagër i vetëm dhe ekskluziv i Komisionerit.

Ndër to më i rëndësishëm ai i cili disponon mbi faktin nëse dy sigla të subjekteve të regjistruara për zgjedhje janë të ngjashme ose jo dhe a shkaktojnë konfuzion e ngatërresë të zgjedhësit. Ky element është lënë nga legjislatori në vlerësim ekskluziv dhe si tagër i patjetërsueshëm i Komisionerit dhe mbi këtë tagër nuk mund të mbivendoset vlerësimi diskrecional i anëtarëve të KAS, pasi roli i tyre i parashikuar në Kodin Zgjedhor nuk e lejon një gjë të tillë. Në rast se sikundër ne, ashtu edhe Komisioneri vlerësojnë se siglat e subjekteve janë të ngjashme atëhere asnjë organ tjetër nuk ka tagrin ta vlerësojë në mënyrë të ndryshme një fakt të tillë por vetëm mund të verifikojë aplikimin sipas ligjit të sanksionit përkatës apo jo.


Përsa i përket sanksionit në këtë rast ai është një dhe i vetëm. Sipas ligjit ai duhet të merret duke i ndaluar subjektit Bindja Demokratike përdorimin e logos në fletën e votimit, sipas modelit të propozuar prej saj, kërkesë e cila nuk është marrë para sysh në vendimarrjen 198/2021, në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të Kodit Zgjedhor.

Aq më tepër nuk duhet të lejohet të zhbëhet në drejtim të kundërt vendimarrja e Komisionerit në këtë pikë, duke mos lejuar as përdorimin e logos së këtij subjekti, sipas disponimit të Komisionerit me vendimin 198/2021 pasi edhe ajo sigël, ndonëse me ndryshime të vogla nga ajo e depozituar nga vetë subjekti në KQZ fillimisht, është aplikuar nga Komisioneri në bashkëveprimë subjektin Bindja Demokratike si dhe është pranuar nga vetë ky i fundit në seancën publike të zhvilluar nga Komisioneri në datën 01.04.2021.

Provë për këtë është fakti që subjekti bindja Demokratike nuk e ka kundërshtuar këtë pikë gjatë vendimarrjes së komisionerit por vetëm disa orë më vonë kësaj vendimarrje.

Gjithsesi, duke marrë në konsideratë logjikën me të cilën është hartuar dispozita, neni 66 i Kodit Zgjedhor, dispozitë e cila parashikon vetë një sanksion dhe një linjë veprimi, si dhe faktin që aplikimi i saj varet vetëm nga konstatimi i disa fakteve ligjore mbi të cilat s'mund të disponojë askush- tagrin ekskluziv të komisionerit për të përcaktuar ngjashmërinë ose jo- **urdhërimi nuk mund të jetë veçse një dhe i vetëm: Ndalimi i përdorimit të siglës së subjektit Bindja Demokratike në fletën e votimit për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021.**

Argumenti i ngritur nga përfaqësuesi i subjektit Bindja Demokratike, në seancën e shqyrtimit në KAS , se Bindja Demokratike nuk kishte dhënë pëlqimin për përdorimin ndonjë logoje të ndryshme nga ana e Komisionerit, nuk është ligjor pasi ligji në asnjë vend, e aq më pak në nenin 66, nuk parashikon dhënien e



pëlqimit ose jo. Ligji parashikon vetëm ndalimin e përdorimit dhe në këtë pikë ne insistojmë në aplikimin e drejtë të tij në këtë rast.

Lidhur me kriteret e tjera ligjore që parashikon dispozita është paarsyeshme të ndalem me evidentimin e subjektit që fiton epërsinë në përdorimin e logos pasi subjekti ynë është historik dhe ka 30 vjet që garon me të njëjtin emër dhe logo në të gjitha garat zgjedhore prej vitit 1991 e deri më sot, cka për efekt të ligjit ka një përparësi të pakrahasueshme me nje subjekt politik të krijuar në vitin 2019.

V. KONKLuzion

Përsa më sipër, duke konsideruar se vendimi nr. 19 i datës 03.04.2021 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve/KAS është i paligjshëm,

KËRKOJMË

- 1- Shfuqizimin e Vendimit të KQZ/KAS Nr. 19 datë 03.04.2021.
- 2- Gjykimin e çështjes në themel duke vendosur pranimin e kërkesës ankimore nr.10 të paraqitur nga Koalicioni Partia Demokratike- Aleanca për Ndryshim dhe rrëzimin e kërkesave ankimore nr.08 dhe 09 të paraqitura nga Partia Socialiste e Shqipërisë dhe Partia Bindja Demokratike.


PADITESI

PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË- Aleanca për Ndryshim

Përfaqësuesi i autorizuar

IVI KASO

Ivi Kaso





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE
SANKSIONEVE

Data: 3 Prill 2021

Nr: 19

SHKURTIM - VENDIMI

“PËR SHQYRTIMIN BASHKËRISHT TË KËRKESAVE ANKIMORE NR. 08 TË PARTISË SOCIALISTE TË SHQIPËRISË, NR. 09 TË PARTISË BINDJA DEMOKRATIKE DHE NR. 10 TË KOALICIONIT PARTIA DEMOKRATIKE-ALEANCA PËR NDRYSHIM NDAJ VENDIMIT TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE NR. 198, DATË 01.04.2021”

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 03.04.2021, me pjesëmarrjen e:

Koli BELE	-	Kryesues
Elvin LAKO	-	Anëtar
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan RUSMALI	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar

Në prani të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm,

Shqyrtoi çështjen me:

Ankues :

1. Partia Socialiste e Shqipërisë, përfaqësuar nga z. Eridian Salianji
2. Partia Bindja Demokratike, përfaqësuar nga z. Fabian Topollari
3. Koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim, përfaqësuar nga z. Ivi Kaso.

OBJEKTI:

Shqyrtimin e kërkesave ankimore nr. 08, datë 01.04.2021 të Partisë Socialiste të Shqipërisë; nr. 09, datë 01.04.2021 të Partisë Bindja Demokratike dhe nr. 10, datë 02.04.2021 të koalicionit Partia Demokratike-Aleanca për ndryshim, me objekt të përbashkët “Ndryshimin e vendimit nr.198, datë 01.04.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ‘Për miratimin e përmbajtjes së fletëve të votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021’”.



Data: 3 Prill 2021
Nr. 19, Ora 11

Për shqyrtimin e kërkesave ankimore nr.08, nr. 09 dhe nr.10, ndaj vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.198, datë 01.04.2021

BAZË LIGJORE: Bazuar në nenet 97, 98 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; vendimi nr. 06, datë 26.02.2021 “Për miratimin e specifikimeve teknike të fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021” të Komisionit Rregullator; si dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 30 të vendimit nr. 3, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullores “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”, në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

KAS në përfundim të shqyrtimit administrativ të ankimeve kundër vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 198, datë 01.04.2021, bazuar në analizën e fakteve dhe provave të administruara, me shumicë votash, mbështetur në shkronjën “c” të pikës 1 të nenit 30 të vendimit nr. 3, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator,

V E N D O S I:

1. Ndryshimin e vendimit nr.198. datë 01.04.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e përmbajtjes së fletëve të votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.
2. Pranimin e kërkesës ankimore nr. 08 të paraqitur nga Partia Socialiste e Shqipërisë.
3. Pranimin e kërkesës ankimore nr. 09 të paraqitur nga Partia Bindja Demokratike, duke vendosur në përmbajtje të fletës së votimit logon e ristilizuar të depozituar nga ky subjekt zgjedhor.
4. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 10 të paraqitur nga koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit, Tiranë brenda 5 ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

Koli BELE

- Kryesues

Elvin LAKO

- Anëtar

Elvis ÇEFA

- Anëtar

Ilirjan RUSMALI

- Anëtar

Ledio BRAHO

- Anëtar

KUNDER

KUNDER



Nr. Extra prot.

Tiranë 01/03/2021

A U T O R I Z I M

I PËRFAQËSUARI: KOALICIONI “PARTIA DEMOKRATIKE- ALEANCA PËR NDRYSHIM” “PD-AN”, përfaqësuar ligjërisht prej **Z. Lulzim BASHA** në cilësinë e kryetarit të partisë “Partia Demokratike e Shqipërisë” lëshon këtë autorizim me përmbajtje si më poshtë:

Emëroj si **përfaqësues të posaçëm z. Ivi Spiro KASO**, të cilit i jap të drejtë, tagër dhe porosi që të përfaqësojë Koalicionin **“PARTIA DEMOKRATIKE- ALEANCA PËR NDRYSHIM” “PD-AN”** :

- *në çdo shqyrtim administrativ pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në të cilin “PD-AN” do të jetë në cilësinë e ankuesit ashtu edhe të palës së interesuar.*
- *në çdo çështje gjyqësore që do të zhvillohet para Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, Gjykatës së Shkallës së Parë, Gjykatës së Apelit, Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese, në të cilat “PD-AN” do të jetë në cilësinë e ankuesit, paditësit, palës së interesuar apo çdo pozicion tjetër procedural gjyqësor.*

Me këtë cilësi përfaqësuesi ka të drejtë të ngrejë padi, kundërpadi, të bëjë shtesë, pakësim ose ndryshim objekti, të zgjidhë çështjen me pajtim, të kërkojë zëvendësim palësh, të ngrejë padi të re, të thërrasë në gjykatë persona të tretë, të interesuarit, të bëjë ankime civile dhe administrative, të heqë dorë plotësisht ose pjesërisht nga gjykimi, të kërkojë përjashtimin e trupit gjykues, të kërkojë marrjen e provave të reja, të kërkojë vendosje dhe ndërrim eksperti, të kundërshtojë vendimet e ndërmjetme dhe përfundimtare, të bëjë prapsime, të kërkojë rishikim vendimi, rekurs, të kërkojë rivendosje në afat, të kërkojë përjashtimin e gjyqtarëve, të përdorë të gjitha mjetet ligjore që i çmon të nevojshme duke ndërmarrë ose kërkuar kryerjen e të gjitha akteve dhe veprimeve procedurale të nevojshme, të parashikuara respektivisht nga Kodi Zgjedhor, Kodi i Procedurave Administrative dhe Kodi i Procedurës Civile, deri në përfundimin e plotë të çështjes duke përfshirë edhe fazën e ekzekutimit të vendimit, të bëjë kërkesë për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit dhe të kërkojë ekzekutimin e tij në organet shtetërore kompetente, dhe në çdo organ të administratës shtetërore. Ai ka të drejtë të përfaqësojë në rigjykimin e çështjes, të parashtojë çdo kërkesë dhe të kërkojë dokumenta para çdo organi administrativ, të emërojë dhe revokojë avokatë të tjerë ose persona të tjerë me keto të drejta, ose më të kufizuara, deri në përfundimin e çdo çështjeje konkrete. Ai ka të drejtë të nënshkruajë për sa sipër.

Autorizimi është hartuar në bazë të neneve 70, 72 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë si dhe të Statutit të Partisë Demokratike të Shqipërisë.

I PËRFAQËSUARI
KOALICIONI “PARTIA DEMOKRATIKE- ALEANCA PËR NDRYSHIM” “PD-AN”

LULZIM BASHA

